



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË

Nr.492 Akti

Datë 25.02.2022 Regj.Them.

Datë 27.02.2022 Vendimi

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

"PËR CAKTIM MASE NDALUESE "

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARI: ARTAN GJERMËNI

Sot më datë **27.02.2022**, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, pa praninë e paleve dhe sekretares gjyqesore, kërkesën që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Arben Agovi**.

KUNDËR:

1.Personit nën hetim **Ardian Afrim Haci**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqata Rajonale Futbollit Tiranë ,me adrese banimi:Njesia Administrative nr.2,Rruga“Hoxha Tasim”, 69/1 ,jo prezent.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale **“Falsifikimi i dokumentave”** të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

OBJEKTI:

Caktimin e masës së sigurimit **“Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”** të parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale.

KUNDËR:

2.Personit nën hetim **Illir Ismail Shulku**,i dtl.21.01.1969, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federata Shqiptare Futbollit (FSHF) me adrese banimi:Bulevardi “Gjergji Fishta” ,Ndertesa 42,H 2, Ap 10,jo prezent.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Shpërdorimi i detyrës**” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*” të parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: 3.Personit nën hetim **Armando Enver Duka**, i dtl 07.10.1962, me detyrë Presidenti i Federata Shqiptare Futbollit(FSHF), me adrese banimi:Shijak, jo prezent.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Shpërdorimi i detyrës**” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*” të parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale.

KUNDËR: 4.Personit nën hetim **Koço Theodhori Kokëdhima**, i dtl 21.04 1957, me detyrë Kryetar i Komisionit të Verifikimit pranë Federata Shqiptare Futbollit, me adrese banimi:Njesia Administrative nr.5, rruga ”Ismail Qemali,Nd 18,Ap 45,H 3,jo prezent.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “**Shpërdorimi i detyrës**” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*” të parashikuar nga neni 240 i K.Pr.Penale.

BAZA LIGJORE: Neni 228, 229, 242, 230, 240, 241, 242 dhe 244 të K.Pr.Penale.

Gjykata, si verifikoi kryesisht kompetencën për shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe pasi u njoh me kërkesën, çështjen në tërësi,

VËREN:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për:*Vendosjen e masave ndaluese dhe konkretisht të ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste, në kuptim të detyrave drejtuese të shtetasve **Ardian Haçi**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqata Rajonale Futbollit Tirana(SHRFT), për veprën penale sipas nenit 186/3 të Kodit Penal; **Ilir Shulku**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federata Shqiptare Futbollit (FSHF); **Armando Duka**,*

me detyrë Presidenti i Federata Shqiptare Futbollit(FSHF) dhe **Koço Kokëdhima**, me detyrë Kryetar i Komisionit të Verifikimit pranë Federata Shqiptare Futbollit, të tre këto të fundit të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi i çështjes nëdhomë këshillimi, në gjendjen që është paraqitur kërkesa dhe aktet, ka rezultuar se:

I. Rrethanat e çështjes;

Nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me datë 26.01.2022, është regjistruar procedimi penal nr.697 viti 2022, për veprat penale të “*Fallsifikimi i dokumenteve*” dhe të “*Shpërdorim të detyrës*” parashikuar nga nenet 186 dhe 248 te K.Penal. Ndërsa, me datë 24.02.2022 është bërë shënimi në regjistër i emrave të personit që i atribuohet vepra penale, konkretisht, emri i personit nën hetim Ardian Haçi për veprën penale “*Fallsifikimi i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186/3 i K.Penal; Armando Duka, Ilir Shulku dhe Koço Kokëdhima, për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*” parashikuar nga neni 248 te K.Penal.

Pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 3693 prot, të datës 25.01.2022 është depozituar kallëzimi penal i bërë nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, njëkohësisht dhe në cilësinë e aksionerit të Klubit të Futbollit Tirana ndaj shtetasit Ilir Shulku me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ardian Haçi me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë për veprat penale “*Falsifikim i dokumentave*”, “*Falsifikimi kompjuterik*” dhe “*Shpërdorim i detyrës*”, parashikuar nga nenet 186, 186/a dhe 248 i Kodit Penal. Kallëzimi mbështetet në veprimet e kundraligjshme të ndërmarra nga shtetasit Ilir Shulku dhe Ardian Haçi, në procedurën e zgjedhjes së Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës.

Në kallëzim pretendohet se, në datë 24.01.2022, rreth orës 15:00, ka qënë planifikuar të zhvillohej mbledhja e delegatëve për zgjedhjen e Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës, ku në garë kanë qënë dy kandidatë, konkretisht shtetasi Krenar Alimehmeti si dhe Eduard Prodani, ky i fundit është tërhequr pak pas nisjes së mbledhjes, pasi sipas tij janë konstatuar një sërë shkeljesh ligjore dhe mungese transparence, për shkak se nuk janë vënë në dispozicion paraprakisht lista e delegatëve me të drejtë vote.

Bashkia Tiranë është aksionere e Klubit të Futbollit Tirana dhe pjesë e Shoqatës Rajonale e Futbollit të Tiranës, e cila përbëhet nga 41 persona juridikë, ku secili prej anëtarëve përzgjedh delegatët përfaqësues me të drejtë vote, në zgjedhjen e kreut të ri të shoqatës. Në ambientin ku ishte planifikuar të zhvillohej mbledhja kanë qënë prezent 67 anëtarë nga 41 që duhet të jenë, ku 24 anëtarë kanë qënë persona anonim (delegatë jo-legjitim) të përzgjedhur në mënyrë të kundraligjshme nga përfaqësues të FSHF-së, me qëllim ndikimin në procesin e zgjedhjes së Kreut të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Tiranës, duke paracaktuar rezultatin.

Ne kallëzim pretendohet për veprime të kundraligjshme në kuadër të zhvillimit të mbledhjes përkatëse, konkretisht: 1. Në listën jo të plote dhe të manipuluar, të vënë në

dispozicion para pak kohësh, anëtarëve të shoqatës (personave juridik), me justifikimin për thirrjen embledhjes së delegatëve; 2. Ka informacione që në mbledhjen e datës 24.01.2022 të orës 15.00 të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, me telefon nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit Ilir Shulku është kërkuar e kanë marrë pjesë në këtë mbledhje persona që nuk kanë asnjë lloj lidhje me shoqatën në kundërshtim të plotë me statutin e federatës që përcakton që delegatet duhet të jenë punonjës të anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë. Personat për të cilët ka një informacion të tillë janë: a. Altin Kello; b. Ajson Lala; c. Ervin Bukaci; d. Aldi Masha; 3. Në moszbatimin e procedurës administrative për zhvillimin e mbledhjes së delegatëve, ku në rastin konkret nuk është zbatuar procedura standarte nga Komisioni i Verifikimit, në lidhje me identifikimin e plotë të delegatëve me të drejtë vote, si dhe lista përkatëse e delegatëve legjitim nuk i është vënë në dispozicion kandidatëve paraprakisht. 4. Zhvillimi i mbledhjes mbi kuorumin e nevojshëm, me pjesëmarrjen e 67 anëtarëve nga 41 që duhet të jenë, ku 24 anëtarët prezent kanë qënë persona anonim (delegatë jo-legjitim). Në këto kushte cmojmë së janë përdorur lista fiktive votuesish, duke falsifikuar nënshkrimet e delegatëve legjitim me të drejtë vote, të cilët kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes; 5. Njoftimet e anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë janë njoftuar nëpërmjet një emaili i cili nuk administrohet nga anëtarët e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, por sipas informacioneve, këto emailë janë hapur nga punonjësit të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe administrohet po nga ata. Duke futur në këtë mënyrë apo hequr të dhëna në mënyrë të paautorizuar nga sistemi elektronik nën administrimin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë, me pasoje pavorshmerine e njoftimeve dhe vendimeve të kësaj shoqate.

Në kallezimin penal pretendohet se shkeljet nga personat përgjegjës janë bërë me një qëllim të vetëm, ndikimin apo paracaktimin e rezultatit të zgjedhjes së Kreut të Shoqatës së llit të Tiranës, sipas interesave klienteliste të kreut aktual të FSHF-së.

Në funksion të hetimeve (deri në këtë fazë), në datën 25.01.2022 është bërë kqyrja në GOOGLE në lidhje me disa artikuj të ndryshëm të paraqitura në disa prej gazetave online në data të ndryshme që paraqesin interes për hetimin e këtij kallëzimi penal. Grupi hetimor është paraqitur në datë 26.01.2022 në ambjentet e FSHF ku ka sekuestruar praktikën për regjistrimin e shoqatave të futbollit në procesin e zgjedhjeve për kryetarin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë si dhe procedurën e njoftimit të shoqatave nga ana e SHRF-Tiranë.

Në datën 27.01.2022 janë këqyru pamjet fimore të zhvillimit të asamblesë për zgjedhjen e kryetarit të shoqatës SHRF-Tiranë. Në vijim, po në të njëjtën datë është sekuestruar dosja gjyqësore nr.363 akti e datës 25.01.2022 e cila në brëndësi ka praktikën origjinale për regjistrimin e veprimeve të kryera në datën 24.01.2022 në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme për zgjedhjen e kryetarit të ri për shoqatën SHRF-Tiranë.

Në datën 14 dhe 15.02.2022 është këqyru dhe marrë dokumentacioni i disa shoqatave anëtare të SHRF-Tirana i cili përbëhet nga certifikata personale dhe ose familjare, si dhe

kartela mjeksore të lojtarëve të futbollit të federuar në këto shoqata si dhe deklaruar në sistemin "Comet".

Në vijim janë pyetur më shumë se 40 persona në cilësinë e deklaruesve të cilët janë kryetar të shoqatave, antarë si dhe delegatë. Nga këto deklarime ka rezultuar se një numër i delegatëve janë të punësuar në formë vullnetare ose duke mos qënë të deklaruar pranë organeve tatimore, në këto shoqata duke e bërë të pa mundur lidhjen e tyre direkte me shoqatat në zbatim të statutit të SHRF-Tiranë.

Nga këqyrja dhe marrja e dosjeve të shoqatave të futbollit të antarësuar pranë SHRF Tirana, janë konstatuar një sërë shkeljesh lidhur me administrimin e dokumentacionit për lojtarët e federuar duke mos patur rakordim të saktë në numrin e deklaruar në sistemin "Comet" krahasuar me gjëndje reale faktike të ndodhura në dosjet.

Për sa më sipër, nga hetimet e deri tanishme ka rezultuar se në disa nga dosjet e ekipeve ka një numër më të vogël lojtarësh të federuar krahasuar me atë të deklaruar në sistemin "Comet" sistem i cili është sistemi që merret për bazë në lidhje me gjenerimin e të dhënave zyrtare për numrin aktiv të lojtarëve të federuar. Numri i lojtarëve të federuar është përcaktues sipas statutit të FSHF dhe SHRFT për përfaqësimin në asamblenë e përgjithshme nga delegatët e cdo shoqate apo klubi pjestarë. Konkretisht në bazë të nenit 28, pika 4 të statutit të SHRFT citohet se "*.....secili delegat ka të paktën 1 votë në asamblenë e përgjithshme. Për efekt përfaqësimi, çdo antari do ti atribuohet edhe nga një delegat për çdo 100 lojtarë të licensuar që marrin pjesë në garat rajonale të të gjitha niveleve. Vetëm delegatët e pranishëm kanë të drejtë vote. Votimi me prokurë ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.....*". Duke qënë se numri i lojtarëve të federuar sipas sistemit "Comet" nuk koresponдон me atë faktik në dosjet e klubeve lind dyshimi i arsyeshëm se mund të jenë shtuar/regjistruar fiktivisht lojtarë të cilët nuk kanë kartelat përkatëse në dosjet e ekipeve.

Në bazë të veprimeve hetimore të kryera, sipas organit të akuzës ka rezultuar se ka dyshime të bazuara se personat nën hetim *Ardian Haçi, Ilir Shulku, Armando Duka dhe Koço Kokëdhima*, të kenë kryer veprën penale të "*Falsifikimi i dokumentave*" dhe "*Shpërdorimi i detyrës*" parashikuar nga neni 186/3 dhe 248 të K.Penal.

Për këto fakte të sipërpërmendura, nisur nga rrezikshmëria e veprës penale për të cilën dyshohen personat nën hetim, organi i prokurorisë ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndalues "*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*" të parashikuar nga neni 240 dhe 243 i K.Pr.Penale, për personat nën hetim.

II. Vlerësimi i gjykatës;

Fillimisht, Gjykata e sheh të nevojshme të jap disa vlerësime të përgjithshme në lidhje me kushtet, kriteret dhe parimet që duhet të udhëheqin gjykatën në raport me caktimin e masava të sigurimit personal (masat shtrënguese dhe ndaluese).

Masa e sigurimit ka karakter taksativ, që do të thotë se, mund të caktohen vetëm ato që ligji i parashikon si të tilla. Ato kanë karakter gjyqësor, pasi artikuloohen konkretisht vetëm

nëpërmjet një vendimi gjyqësor. Kjo cilësi e masave pasjell karakterin e tyre diskrecional dhe vlerësues, pasi Gjykata nëpërmjet hulumtimit mbi aktet që serviren nga palët dhe mbi ligjin në fuqi do të arrijë të bëjë një analizë dhe të konkludojë mbi caktimin e masës konkrete. Çdo masë sigurimi ka si karakteristikë disponibilitetin e përhershëm të prokurorit, si organi që inicion rishtazi kërkesën dhe si organi që ka vlerësimin ekskluziv mbi nevojën maksimale të procedimit mbi masën që zgjedh të kërkojë, dhe vlerësimin e pasuar nga vendimmarrja e gjykatës. Gjithashtu, ato kanë karakter të jashtëzakonshëm, pasi caktimi i tyre nuk është aksesor i përhershëm i procedimit penal dhe si rrjedhim caktimi i tyre nuk është rregull, por një përjashtim nga rregulli. Kështu, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar në Titullin V të emërtuar neni 232 dhe 240 ka parashikuar llojet e masave të sigurimit.

Për të vlerësuar kërkesën e prokurorit, Gjykata ka për detyrë funksionale të shqyrtojë të gjitha rrethanat, në favor ose kundër ekzistencës së një interesi publik, që për ligj një përjashtim nga parimi i respektimit të lirisë së individit, duke pasur parasysh prezumimin e pafajësisë dhe paraqitjen e tij në argumentimin e vendimit të dhënë¹. Ashtu si masat me karakter shtrëngues, edhe masat e sigurimit me karakter ndalues caktohen vetëm në rast se: i) *ekzistondyshimi i arsyeshëm, i bazuar në prova*; ii) *ekziston vepra penale (vepra nuk është shuar)*; iii) *ekzistenca e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale*.²

Në lidhje me ekzistencën e “dyshimin e arsyeshëm”, Gjykata sjell në vëmendje se standardi i dyshimit të arsyeshëm presupozon ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim të ketë kryer veprën penale. **Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht një drejtimesh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.**³ Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim së të gjykuarit (*fumus commissi delicti*) është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit, që normalisht për të qëndruar kjo e fundit nevojitet që dyshimi të qëndrojë i palëkundur në vijimsi. Gjykata thekson se, ekzistenca e dyshimit të bazuar, se personi i arrestuar ka kryer një krim, përbën kusht *sine qua non* për rregullshmërinë e mbajtjes në paraburgim, por, me kalimin e një kohe të caktuar, ai nuk është më i mjaftueshëm.

Gjykata sjell në vëmendje gjithashtu se, standardi i të provuarit në këtë lloj seancë (*dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova*) është krejt i ndryshëm me standardin e të provuarit në një gjykim penal themeli (*tej çdo dyshimi të arsyeshëm*). Kështu, në rastin e caktimit të masave të sigurimit, gjykata nuk mund të bëjë analizën e provave, por duhet të respektojë rigorozisht kërkesën e nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një

¹ Shiko paragrafin 84 të Vendimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut *Tomasi kundër Francës*, dt. 27.08.1993.

² Shiko vendimin Nr. 22, datë 25.06.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³ Shiko Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 7, dt. 14.10.2011, faqe 8.

dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në disa prej vendimeve të saj në interpretim të togfjalëshit “*dyshimi i arsyeshëm*”, është shprehur se: “*Dyshimi i arsyeshëm parashikon ekzistencën e provave të besueshme, të cilat mund ta bindin vëzhguesin e paanshëm se një person i caktuar mund të ketë kryer veprën penale, për të cilën dyshohet*” (shih çështjet e Ciulla kundër Italisë, Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar).

Në lidhje me “ekzistencën e veprës penale”, si kusht i përgjithshëm për caktimin e masës së sigurimit, Gjykata çmon se ky kusht nënkupton që fakti i dhënë për të cilin akuzohet personi nën hetim të parashikohet nga ligji si vepër penale dhe kjo vepër të mos jetë shuar për efekt të parashkrimit ose dispozitës përkatëse. Në lidhje me këtë kusht GJEDNJ në vendimmarrjen e saj ka arsyetuar se nuk mund të flitet për “dyshime të bazuara” nëse veprimi për të cilin akuzohet një person nuk përbën shkelje ligjore të dënueshme sipas ligjit në çastin e kryerjes së veprës penale (shih çështjen Loukanov kundër Bullgarisë).

Në lidhje me “ekzistencën e kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale”, si kusht i përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit, në kuptim dhe zbatim të nenit 228/2 të K.Pr.Penale, Gjykata çmon se, ky kushtlidhet me plotësimin e kushteve, për të qenë subjekt i veprës penale, si dhe me mosekzistencën e shkaqeve ligjore që e përjashtojnë të dyshuarin nga përgjegjësia penale, siç janë kryerja e veprës penale në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme. Nënenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se: “*Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmëdhjetë vjeç*”. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): *i*) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe *ii*) të jetë i përgjegjshëm.

Përpos kushteve të përgjithshme (të cilat duhen të plotësohen në mënyrë komulative) të parashikuara nga neni 228 i K.Pr.Penale, Gjykata çmon se, për aplikimin e masave të sigurimit është e domosdoshme prania e kushteve të veçanta (të paktën një nga këto kushte) të cilat janë përkatësisht *i*) *ekzistenca e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; ii*) *largimi ose ekzistenca e rrezikut që i hetuari të largohet dhe iii*) *ekzistenca e rrezikut që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai po procedohet*. Pika 3 e nenit 228 vë kushte të cilat nuk janë domosdoshmërisht kumulative për t’u plotësuar, megjithatë mund të ekzistojnë edhe njëherazi, por mjafton ekzistenca e njëres prej tyre që të nxjerrë në konkluzion gjykatën se jemi para një rasti të ligjshëm për të caktuar një masë sigurimi personal, pra kanë karakter ligjor alternative. Gjykata çmon të trajtojë plotësimin e këtyre kushteve, në raport dhe me nenet 229 e 230 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me ekzistencën e “rrezikut të helmimit të provave”, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera

theksohet se: “Nga interpretimi i drejtë i kuptimit që duhet t’i jepet termit “rrezik” në nenin 228 në tërësi, pra edhe për rastin e shkronjës “a” të këtij neni, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se në çdo fazë të procedimit, kërkesa e paraqitur nga ana e prokurorit dhe vendimi i gjykatës për caktimin e masës së sigurimit duhet të motivohen dhe të argumentojnë (konkretisht) nevojën e sigurimit, ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme, të “rrezikut”, pra të probabilitetit, mundësisë reale që të ndodhë (id quod plerumque accidit) vënia në rrezik e procesit të së provuarit nga ana e të pandehurit. Kjo gjendje “rreziku” mund të verifikohet, pra mund të lindë, ndryshojë apo mbarojë, rast pas rasti, në dinamikë, si gjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë fazës së gjykimit. Përfundimi i gjykatës lidhur me gjendjen e rrezikut, arrihet bazuar në tërësinë e rrethanave të faktit e të ligjit që e sjellin atë gjykatë në përfundimin mbi ekzistencën e kësaj gjendje, e cila pengon, ngadalëson apo devijon në mënyrë të parregullt procesin e të provuarit dhe vërtetimin e rrethanave të faktit të lidhura me procedimin penal përkatës, në kuadër të garantimit të procesit të dhënies së drejtësisë në tërësi të parashikuar nga Kushtetuta e që pikërisht justifikon parashikimin në ligj të caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit. Vlerësimi i rrethanave mbi ekzistencën ose jo të rrezikuar për “helmimin” e provave, bëhet rast pas rasti. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohet verifikimi që i bën gjykata edhe rrethanës mbi kohën që ka kaluar nga çasti i vënies në dijeni të të pandehurit për procedimin penal në ngarkim të tij, në lidhje me rrethanën nëse ka kryer apo mund të kryejë ndonjë veprim a sjellje që “rrezikon” procesin e marrjes dhe vërtetësisë së provës. Në këtë kontekst, në parim, edhe e drejta e heshtjes së të pandehurit, si një strategji mbrojtjeje e tij, nuk përbën në vetvete “rrezik” që mund të shërbejë si motiv për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaj tij. Gjithsesi, edhe kjo rrethanë mund të vlerësohet në harmoni dhe në lidhje me sjelljet e tjera të tij ndaj veprës që ka kryer dhe procedimit penal të filluar, të cilat mund të çojnë gjykatën në bindjen se ekziston dyshim i bazuar në prova se i pandehuri nëse lihet i lirë do të helmojë provat dhe procesin e të provuarit, sikurse janë kërkimi, marrja, vërtetësia dhe ruajtja e provës e të burimeve të provës, nga ana e të gjykuarit.”.

Gjithashtu, në lidhje me ekzistencën e “rrezikut të largimit”, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata mban parasysht qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet: “... **“rreziku i largimit”, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj. Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja “b” nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitet të ikjes së të gjykuarit. Për efekt të motivimit të caktimit të masës së sigurimit, një nga rastet që**

*përbën element objektiv për të sjellë gjykatën në përfundime mbi largimin dhe rrezikun e largimit, është edhe gjendja e ikjes pa lënë gjurmë (fshehjes) të pandehurit. Kjo gjendje, në vetvete, mishëron logjikisht e juridikisht prirjen e të pandehurit për të shkelur dhe mos zbatuar masat e sigurimit (përfshi arrestin në burg), qenien e tij në mënyrë permanente në pozitën e mosbindjes së paligjshme përballë ligjit, prirjen për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimin, si dhe vuajtjes së dënimit. Kjo gjendje rreziku normalisht mbetet e tillë edhe nëse i pandehuri i deklaruar i ikur, më pas, tregon disponibilitetin e tij që të paraqitet apo kur paraqitet vullnetarisht para organeve të procedimit. **Një nga arsyet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimin në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë.**”*

Problemi i përcaktimit të mundësisë që i pandehuri t'i shmanget hetimit ose gjykimin të çështjes, si rrethanë që e bën të justifikuar zgjedhjen e njëres nga masat e sigurimit të përcaktuara nga ligji, paraqet vështirësi për faktin se gjykata mbi bazën e materialeve të çështjes duhet të zgjidhë me supozime çështjen e paraqitjes së të dyshuarit në hetim apo gjykim, sa herë të jetë e nevojshme. Vetëkuptohet se vetëm mbi bazën e provave të mbledhura në çështjen penale do të përcaktohet mundësia që i dyshuari t'i shmanget hetimit ose gjykimin të çështjes si dhe shkalla e kësaj mundësie në varësi të së cilës është edhe zgjedhja e kësaj apo e asaj mase sigurimi. Kur flitet për shmangie nga hetimi apo gjykimin i çështjes kemi parasysh një veprim të kryer me dashje, me ndërgjegje të plotë dhe me qëllim të caktuar, domethënë që i dyshuari braktis vendbanimin apo vendqëndrimin e tij të zakonshëm dhe largohet në drejtim të paditur me qëllim që t'i shmanget hetimit dhe gjykimin. Pra, jo çdo largim i të dyshuarit nga vendqëndrimi ose vendbanimi i tij duhet quajtur shmangie nga hetimi dhe gjykimin por duhet vlerësuar rast pas rasti. Duke qenë se mendimi për t'iu shmangur hetimit dhe gjykimin të çështjes është i fshehur në psikikën e të dyshuarit, ai nuk mund të vërehet menjëherë. Për përcaktimin e drejtë të saj do të ndihmonin shumë njohja e motiveve të ndryshme që e bëjnë të besueshme në një masë të përafërt por të mjaftueshme se i pandehuri kërkon t'i shmanget hetimit apo gjykimin. Pjesërisht faktorët që e motivojnë shmangien janë të shprehura edhe në ligj. Këta faktorë, dhe të tjerë që lindin gjatë procesit penal, duhen vlerësuar drejt dhe në mënyrë të gjithanshme, nga gjykata, duke mbajtur kurdoherë parasysh tërësinë e provave që janë mbledhur, deri në atë moment, për çështjen. Kështu në nenin 229/2 të K.Pr.Penale si kriter në caktimin e masës së sigurimit mund të shërbejë edhe rrezikshmëria shoqërore e veprës penale. **Duke trajtuar në ligj rrezikshmërinë shoqërore të veprës ligjvënësi ka parasysh jo vetëm vendin që zë një veprë e caktuar në pjesën e posaçme të Kodit Penal por edhe rëndësinë e marrëdhënieve shoqërore të prekura apo të cënuara prej saj, pasi ligji parashikon shprehimisht si kriter rëndësinë e faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete.**

Nga studimi i të gjitha rrethanave që lidhen me rrezikshmërinë shoqërore të veprës mund të zgjidhet drejt edhe çështja e mundësisë të të pandehurit për t'iu shmangur hetimit apo gjykimit. Dihet se sa më e madhe të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale për të cilën dyshohet personi aq më i rëndë është edhe dënimi i parashikuar për veprën penale konkrete. **Por, një dënim i rëndë për një vepër penale të dyshuar se është kryer nga personi, është plotësisht logjike të pranohet se mund të lindë tek ai mendimin për t'iu shmangur hetimit apo gjykimit me qëllim për t'i shpëtuar vuajtjes së këtij dënimi.**⁴

Në lidhje me ekzistencën e “rrezikut që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin ai po procedohet”, si një nga kushtet alternative për caktimin e masave të sigurimit, Gjykata, gjithashtu, mban parasysh qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 7, datë 14.10.2011, ku ndër të tjera theksohet: “11. Në shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet rasti (kushti) “kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të së pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të së njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”. Përmbajtja e dispozitës së sipërcituar të shkronjës “c” të pikës 3 të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhet me nevojën për caktimin e masës së sigurimit për të përmbushur funksionin parandalues të posaçëm të shtetit për garantimin e rendit e të sigurisë publike, paprekshmërinë e jetës, shëndetit, pronës dhe interesave e të drejtave të tjera të ligjshme nga kryerja e veprave të tjera penale nga ana e të pandehurit. Në këtë aspekt, për të legjitimuar kufizimin e lirisë së të pandehurit, pra caktimin e masës së sigurimit, mes të tjerave, objekti i gjykimit është verifikimi i rrethanave konkrete të faktit të cilat i shërbejnë gjykatës për të vlerësuar e konkluduar mbi rrezikshmërinë e autorit dhe, nga ana tjetër, për të përcaktuar veprat penale që ka rrezik të kryhen prej tij. Në këtë kuptim, për pranimin e ekzistencës së nevojës së sigurimit, të rrezikut konkret për komunitetin, çënimin e rendit dhe të sigurisë publike, të cilat justifikojnë caktimin e masës së sigurimit sipas kësaj dispozite, objekt i hetimit gjyqësor duhet të jetë vlerësimi konkret i rrethanave të faktit, duke nxjerrë nga sjellja në tërësi e të gjykuarit elemente konkrete të vlefshme për të bazuar dhënie të vendimit. Sikurse për rastet e rrezikut për “eliminimin” e provave dhe atij të ikjes, edhe në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, **nisur nga kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale dhe atyre të neneve 48 e 50 të Kodit Penal, gjykata duhet të hetojë, në gjendjen që është procedimi, në drejtim të personalitetit të së pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjellja e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare e sociale të tij. Bazuar në vlerësimin e provave mbi ekzistencën e elementeve konkrete të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të së gjykuarit, jo domosdoshmërisht kumulative, gjykata nxjerr përfundimin**

⁴Shiko vendimin Nr. 92, datë 03.06.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

nëse ekziston dyshim i arsyeshëm mbi rrezikshmërinë e tij dhe nevojën për të garantuar paprekshmërinë e komunitetit, nëse ekziston mundësia reale që i gjykuari në të ardhmen, duke qenë në gjendje të lirë, mund të kryejë vepra penale të rënda apo të së njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar.”.

2.1 Caktimi i masës së sigurimitme karakter ndalues për personin nën hetim Ardian Haçi.

Në lidhje me personin nën hetim Ardian Haçi, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar si masë sigurimit **“Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”**, të parashikuar nga neni 243 i K.Pr.Penale, pasi çmon se, në ngarkim të personit nën hetim, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ka konsumuar veprat penale **“Falsifikimi i dokumentave”** parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

Në lidhje me kriterin e dyshimit të arsyeshëm, nga aktet që ndodhen në dosje, konkretisht, procesverbali i sekuestrimit për regjistrimin e shoqatave të futbollit në procesin e zgjedhjeve për kryetarin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë si dhe procedurën e njoftimit të shoqatave nga ana e SHRF-Tirana; procesverbali i datës 27.01.2022 me të cilën janë këqyru pamjet fimike të zhvillimit të asamblesë për zgjedhjen e kryetarit të shoqatës SHRF-Tirana; procesverbalet për marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana për hetimin; si dhe nga vlerësimi tërësor i akteve të realizuara deri në këtë fazë, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim e ka kryer faktin penal për të cilën hetohet.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit apo ndaluese është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e eventuale e personit nën hetim, lidhur me akuzën, për të cilën procedohet, që edhe vete gjykata e apelit e pranon në vendimin e saj.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë shterues, domosdoshmërisht në drejtim të përgjegjësisë së personit që hetohet. Pavarësisht, këtij dyshimi të arsyeshëm, se i hetuari mund të ketë kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit, do të vendoset nëse vërtetohet fajësia, apo pafajësia e personit nën hetim.

Në këtë fazë të procedimit penal është i mjaftueshëm **“dyshimi”** se, personi mund të jetë autor i mundshëm i veprës penale, dyshim, i cili mbështetet në gjendjen që janë aktet e çështjes në procesin e hetimeve paraprake dhe që dallon nga koncepti i **“fajësisë”**, i cili mbështetet në provat që janë objekt i debatit gjyqësor. Gjykata, në këtë fazë gjykimi nuk mund të shprehet në themel, në lidhje me ekzistencën e elementëve të figurës së veprave penale, por vetëm shqyrton dhe mjaftohet me praninë e elementëve të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, bazuar në gjendjen që janë aktet, që çojnë në konkluzionin se, vepra penale, sa më sipër, mund të jetë kryer nga ky shtetas.

Në lidhje me kriterin e **“ekzistencës së veprës penale”** si dhe **“ekzistencës së kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale”**, rezultojnë se në rastin konkret ato plotësohen. Fakti penal në rast konkret, që konsiston në veprimet e personit nën hetim deri në këtë fazë

dyshohet të jetë ajo e falsifikimit të dokumentave, vepër penale e parashikuar në nenin 186/3 të Kodit Penal, si dhe për personin nën hetim nuk ekzistojnë kushte padënueshmërie si dhe ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit **“Pezullimin e ushtrimit të detyrës”** të parashikuar nga neni 240/1/b i K.Pr.Penale, Gjykata vlerëson se, kjo kërkesë e organit të akuzës është e bazuar në ligj.

Neni 242 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.”* Caktimi i masës ndaluese sipas kësaj dispozite zbatohet ndaj personit nën hetim/të pandehurit i cili është në një detyrë apo funksion publik gjatë kohës që ai është në një procedim penal. Kjo masë ndaluese në çdo rast caktohet kur plotësohen kushtet dhe kriteret që përcakton neni 228 i K. Pr. Penale. Një masë e tillë ndaluese nuk mund të caktohet ndaj personit nën hetim që nuk është duke ushtruar një detyrë apo funksion publik, sepse një masë e tillë nuk do të kishte kuptim dhe do të dilte jashtë qëllimit të ligjvënësit.

Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se marrja e një mase të tillë është e nevojshme pasi ekziston koneksiteti i kërkuar ndërmjet faktit penal dhe detyrës që ushtron personi nën hetim. Vepra penale për të cilën hetohet personi nën hetim dyshohet të jetë kryer për shkak të pozitës së veçantë që ka personi nën hetim, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i SHFR Tirana, pozitë e cila i ka mundësuar edhe aksesin dhe mundësinë për të ndërhyrë në përpilimin e rregullt të dokumentacionit për të pasqyruar rrethana apo fakte në kundërshtim me funksionimin e rregullt të mbledhjes së shoqatës rajonale që ai mbulon, dhe për këtë shkak një masë e tillë do t'i shërbente hetimit por edhe do të shërbejë si shkak për të parandaluar çdo dyshim për mundësinë për të ndërhyrë në vijueshmërinë normale të provave/hetimit.

Në caktimin e masës ndaluese parashikuar nga neni 242 i KPP, gjykata ka si qëllim ndërprerjen e aktivitetit të kundërligjshëm të tij në rrethanat konkrete të çështjes, pasi ushtrimi i detyrës së të dyshuarit ka lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij. Në këtë kontekst ka një rrezik real dhe nevojë për marrjen e një mase procedurale për të shmangur mundësinë që ka personi nën hetim, të vazhdojë aktivitetin e tij, e cila ka lidhje të drejtpërdrejte me veprimin e tij të kundërligjshëm.

Nga ana tjetër plotësohet edhe kushti formal i parashikuar nga neni 241 i KPP, lidhur me kushtet e zbatimit të masave ndaluese, i cili parashikon se, *masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit.* Vepra penale për të cilën dyshohet personi nën hetim parashikon dënim nga një deri në shtatë vjet burgim.

Në lidhje me argumentin apo analizën e thelluar të provave, gjykata vlerëson se, për natyrën e këtij gjykimi, ndryshe kur ndaj të hetuarve caktohet një masë sigurimi shtrënguese, nga ato që kufizojnë lirinë e të hetuarit, e konkretisht masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të K. Pr. Penale (duke argumentuar shkaqet pse masat e tjera janë të papërshtatshme). Në rastin konkret, ndaj personit nën hetim është kërkuar të caktohet një

masë ndaluese, për të cilat ligji procedural penal parashikon vetëm një kusht të posaçëm për zbatimin e tyre - 'kur i hetuari procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit. Në rastin konkret, i hetuari dyshohet për veprën penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi i tretë i të cilit parashikon një dënim me burgim nga një deri në shtatë vjet.

Në lidhje me llojin e masës ndaluese të kërkuar nga organi i akuzës, gjykata vleron se, nuk jemi në rastin e nenit 240/1/b dhe 243 të KPP, por në situatën e parashikuar nga neni 240/1/a dhe 242 të KPP. Neni 242 i KPP normon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, ndërkohë që neni 243 normon ndalimin e ushtrimit të profesionit ose afariste në sektorin privat. të detyrave drejtuese në persona juridikë. Pyetja që shtrohet është: pozicioni i sekretarit të përgjithshëm në shoqatat rajonale/kombëtare të sportit apo në detyrën e presidentit të FSHF-së konsiderohen një detyrë që futet në sferën e atyre shërbimeve që paraqesin interes publik (duke përjashtuar organet e administratës shtetërore pasi koncepti i shërbimit publik është më i gjërë se organet shtetërore) apo veprimtari afariste (private)?

Për të sqaruar këto pyetje, i referohemi ligjit Nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, i cili në nenin 7/1 të tij normon: "*Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik*". Në vijim, neni 10 normon se: "*Organizimi kombëtar i sportit përbën tërësinë e organizatave e të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit, të ndara në organizata sportive dhe struktura shtetërore për shërbime sportive*". Ndërsa në nenin 11 parashikohet se: "*Organizatave sportive në Republikën e Shqipërisë janë: a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar; b) federatatsportive; c) shoqatatsportive; ç) shoqëritë sportive; d) klubet sportive*". Në lidhje me financimin e tyre, në nenin 13 parashikohet se: "*1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transfertë, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme*".

Së fundi, i referohemi edhe ligjit Nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë". Neni 3 i tij normon se: "*Ky ligj zbatohet, si rregull, për të gjitha shërbimet që ofrohen nga institucionet e administratës shtetërore... nga institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.*" Në vijim, neni 4, par.10 i tij normon: "*Shërbim publik është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, të pavarura dhe të qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë, në bazë të kërkesës së tyre...*"

Në kushte kur, sporti me ligj është parashikuar si një interes publik që tejkalon interesat private të mënyrës së organizimit të tyre në formën e OJF-së, konkludohet se edhe drejtuesit e tyre ushtrojnë një detyrë apo shërbim që i përket sferës publike.

Për sa më sipër, ndaj personit nën hetim duhet të caktohet masa e sigurimit "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik", parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale.

Cmohet nga gjykata qe ushtrimi i detyres per personin nen hetim Ardian Haçi duhet te ndalohet plotesishte duke perjashtuar veprimet administrative per kryerje pagesash ne favor te perona fizik ose juridik (paga, shlyerje kontratash e te tjera te kesaj natyre)

2.2 Caktimi i masës së sigurimit me karakter ndalues për personin nën hetim Ilir Shulku.

Në lidhje me personin nën hetim Ilir Shulku, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar si masë sigurimit *“Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste”*, të parashikuar nga neni 243 i K.Pr.Penale, pasi çmon se, në ngarkim të personit nën hetim, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ka konsumuar veprat penale *“Shpërdorimi i detyrës”* parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në lidhje me kriterin e dyshimit të arsyeshëm, nga aktet që ndodhen në dosje, konkretisht, procesverbali i sekuestrimit për regjistrimin e shoqatave të futbollit në procesin e zgjedhjeve për kryetarin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë si dhe procedurën e njoftimit të shoqatave nga ana e SHRF-Tirana; procesverbali i datës 27.01.2022 me të cilën janë këqyrur pamjet fimike të zhvillimit të asamblesë për zgjedhjen e kryetarit të shoqatës SHRF-Tirana; procesverbalet për marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana për hetimin; si dhe nga vlerësimi tërësor i akteve të realizuara deri në këtë fazë, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim e ka kryer faktin penal për të cilën hetohet.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit apo ndaluese është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla *që të bëjnë të duket* e mundshme përgjegjësia e eventuale e personit nën hetim, lidhur me akuzën, për të cilën procedohet, qe edhe vete gjykata e apelit e pranon ne vendimin e saj.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë shterues, domosdoshmërisht në drejtim të përgjegjësisë së personit që hetohet. Pavarësisht, këtij dyshimi të arsyeshëm, se i hetuari mund të ketë kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit, do të vendoset nëse vërtetohet fajësia, apo pafajësia e personit nën hetim.

Në këtë fazë të procedimit penal është i mjaftueshëm *“dyshimi”* se, personi *mund* të jetë autor i mundshëm i veprës penale, dyshim, i cili mbështetet në gjendjen që janë aktet e çështjes në procesin e hetimeve paraprake dhe që dallon nga koncepti i *“fajësisë”*, i cili mbështetet në provat që janë objekt i debatit gjyqësor. Gjykata, në këtë fazë gjykimi nuk mund të shprehet në themel, në lidhje me ekzistencën e elementëve të figurës së veprave penale, por vetëm shqyrton dhe mjaftohet me praninë e elementëve të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, bazuar në gjendjen që janë aktet, që çojnë në konkluzionin se, vepra penale, sa më sipër, mund të jetë kryer nga ky shtetas.

Në lidhje me kriterin e *“ekzistencës së veprës penale”* si dhe *“ekzistencës së kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale”*, rezultojnë se në rastin konkret ato plotësohen. Fakti penal në rast konkret, që konsiston në veprimet e personit nën hetim deri në këtë fazë dyshohet të jetë ajo e shpërdorimit të detyrës, vepër penale e parashikuar në nenin

248 të Kodit Penal, si dhe për personin nën hetim nuk ekzistojnë kushte padënueshmërie si dhe ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit **“Pezullimin e ushtrimit të detyrës”** të parashikuar nga neni 240/1/b i K.Pr.Penale, Gjykata vlerëson se, kjo kërkesë e organit të akuzës është e bazuar në ligj.

Neni 242 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.”* Caktimi i masës ndaluese sipas kësaj dispozite zbatohet ndaj personit nën hetim/të pandehurit i cili është në një detyrë apo funksion publik gjatë kohës që ai është në një procedim penal. Kjo masë ndaluese në çdo rast caktohet kur plotësohen kushtet dhe kriteret që përcakton neni 228 i K. Pr. Penale. Një masë e tillë ndaluese nuk mund të caktohet ndaj personit nën hetim që nuk është duke ushtruar një detyrë apo funksion publik, sepse një masë e tillë nuk do të kishte kuptim dhe do të dilte jashtë qëllimit të ligjvënësit.

Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se marrja e një mase të tillë është e nevojshme pasi ekziston koneksiteti i kërkuar ndërmjet faktit penal dhe detyrës që ushtron personi nën hetim. Vepra penale për të cilën hetohet personi nën hetim dyshohet të jetë kryer për shkak të pozitës së veçantë që ka personi nën hetim, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i FSHF-së, ku nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve ka mundësuar apo lejuar ardhjen e pasojave të paligjshme që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Personi nën hetim rezulton të ketë qenë në dijeni të paligjshmërive të sipërcituara dhe nuk ka kryer asnjë veprim me qëllim parandalimin e situatës së paligjshme të krijuar (dyshuar për këtë fazë të hetimit). Pozita e tij dhe detyra kërkon që ai të marrë masa për parandalimin e situatave të paligjshme, dhe për këtë shkak një masë e tillë do t'i shërbente hetimit por edhe do të shërbejë si shkak për të parandaluar çdo dyshim për mundësinë për të ndërhyrë në vijueshmërinë normale të provave/hetimit.

Në caktimin e masës ndaluese parashikuar nga neni 242 i KPP, gjykata ka si qëllim ndërprerjen e aktivitetit të kundërligjshëm të tij në rrethanat konkrete të çështjes, pasi ushtrimi i detyrës së të dyshuarit ka lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij. Në këtë kontekst ka një rrezik real dhe nevojë për marrjen e një mase procedurale për të shmangur mundësinë që ka personi nën hetim, të vazhdojë aktivitetin e tij, e cila ka lidhje të drejtpërdrejte me veprimin e tij të kundërligjshëm.

Nga ana tjetër plotësohet edhe kushti formal i parashikuar nga neni 241 i KPP, lidhur me kushtet e zbatimit të masave ndaluese, i cili parashikon se, *masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit.* Vepra penale për të cilën dyshohet personi nën hetim parashikon dënim deri në shtatë vjet burgim.

Në lidhje me argumentin apo analizën e thelluar të provave, gjykata vlerëson se, për natyrën e këtij gjykimi, ndryshe kur ndaj të hetuarve caktohet një masë sigurimi shtrënguese, nga ato që kufizojnë lirinë e të hetuarit, e konkretisht masat e sigurimit të parashikuara nga

nenet 237, 238 dhe 239 të K. Pr. Penale (duke argumentuar shkaqet pse masat e tjera janë të papërshtatshme). Në rastin konkret, ndaj personit nën hetim është kërkuar të caktohet një masë ndaluese, për të cilat ligji procedural penal parashikon vetëm një kusht të posaçëm për zbatimin e tyre - 'kur i hetuari procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit. Në rastin konkret, i hetuari dyshohet për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili parashikon një dënim me burgim deri në shtatë vjet.

Në lidhje me llojin e masës ndaluese të kërkuar nga organi i akuzës, gjykata vleron se, nuk jemi në rastin e nenit 240/1/b dhe 243 të KPP, por në situatën e parashikuar nga neni 240/1/a dhe 242 të KPP. Neni 242 i KPP normon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, ndërkohë që neni 243 normon ndalimin e ushtrimit të profesionit ose afariste në sektorin privat. të detyrave drejtuese në persona juridikë. Pyetja që shtrohet është: pozicioni i sekretarit të përgjithshëm të FSHF-së apo në detyrën e presidentit të FSHF-së konsiderohen një detyrë që futet në sferën e atyre shërbimeve që paraqesin interes publik (duke përjashtuar organet e administratës shtetërore pasi koncepti i shërbimit publik është më i gjërë se organet shtetërore) apo veprimtari afariste (private)?

Për të sqaruar këto pyetje, i referohemi ligjit Nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar, i cili në nenin 7/1 të tij normon: "*Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik*". Në vijim, neni 10 normon se: "*Organizimi kombëtar i sportit përbën tërësinë e organizatave e të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit, të ndara në organizata sportive dhe struktura shtetërore për shërbime sportive*". Ndërsa në nenin 11 parashikohet se: "*Organizatata sportive në Republikën e Shqipërisë janë: a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar; b) federatat sportive; c) shoqatat sportive; ç) shoqëritë sportive; d) klubet sportive*". Në lidhje me financimin e tyre, në nenin 13 parashikohet se: "*1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transfertë, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme*".

Së fundi, i referohemi edhe ligjit Nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë". Neni 3 i tij normon se: "*Ky ligj zbatohet, si rregull, për të gjitha shërbimet që ofrohen nga institucionet e administratës shtetërore... nga institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.*" Në vijim, neni 4, parg.10 i tij normon: "*Shërbim publik*" është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, të pavarura dhe të qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë, në bazë të kërkesës së tyre..."

Në kushte kur, sporti me ligj është parashikuar si një interes publik që tejkalon interesat private të mënyrës së organizimit të tyre në formën e OJF-së, konkludohet se edhe drejtuesit e tyre ushtrojnë një detyrë apo shërbim që i përket sferës publike.

Për sa më sipër, ndaj personit nën hetim duhet të caktohet masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale.

Çmohet nga gjykata që ushtrimi i detyres për personin nën hetim Ilir Shulku duhet të ndalohet plotësisht duke përjashtuar veprimet administrative për kryerje pagesash në favor të personit fizik ose juridik (paga, shlyerje kontratash e të tjera të kësaj natyre)

2.3 Caktimi i masës së sigurimit me karakter ndalues për personin nën hetim Armando Duka.

Në lidhje me personin nën hetim Armando Duka, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar si masë sigurimit “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*”, të parashikuar nga neni 243 i K.Pr.Penale, pasi çmon se, në ngarkim të personit nën hetim, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ka konsumuar veprat penale “*Shpërdorimi i detyrës*” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në lidhje me kriterin e dyshimit të arsyeshëm, nga aktet që ndodhen në dosje, konkretisht, procesverbali i sekuestrimit për regjistrimin e shoqatave të futbollit në procesin e zgjedhjeve për kryetarin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë si dhe procedurën e njoftimit të shoqatave nga ana e SHRF-Tirana; procesverbali i datës 27.01.2022 me të cilën janë këqyrrur pamjet fizike të zhvillimit të asamblesë për zgjedhjen e kryetarit të shoqatës SHRF-Tirana; procesverbalet për marrjen e të dhënave nga persona që tregojnë rrethana për hetimin; si dhe nga vlerësimi tërësor i akteve të realizuara deri në këtë fazë, krijojnë dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim e ka kryer faktin penal për të cilën hetohet.

Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit apo ndaluese është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e eventuale e personit nën hetim, lidhur me akuzën, për të cilën procedohet, që edhe vete gjykata e apelit e pranon në vendimin e saj.

Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë shterues, domosdoshmërisht në drejtim të përgjegjësisë së personit që hetohet. Pavarësisht, këtij dyshimi të arsyeshëm, se i hetuari mund të ketë kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit, do të vendoset nëse vërtetohet fajësia, apo pafajësia e personit nën hetim.

Në këtë fazë të procedimit penal është i mjaftueshëm “*dyshimi*” se, personi mund të jetë autor i mundshëm i veprës penale, dyshim, i cili mbështetet në gjendjen që janë aktet e çështjes në procesin e hetimeve paraprake dhe që dallon nga koncepti i “*fajësisë*”, i cili mbështetet në provat që janë objekt i debatit gjyqësor. Gjykata, në këtë fazë gjykimi nuk mund të shprehet në themel, në lidhje me ekzistencën e elementëve të figurës së veprave penale, por vetëm shqyrton dhe mjaftohet me praninë e elementëve të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, bazuar në gjendjen që janë aktet, që çojnë në konkluzionin se, vepra penale, sa më sipër, mund të jetë kryer nga ky shtetas.

Në lidhje me kriterin e “ekzistencës së veprës penale” si dhe “ekzistencës së kushteve të dënueshmërisë sipas të drejtës penale”, rezultojnë se në rastin konkret ato plotësohen. Fakti penal në rast konkret, që konsiston në veprimet e personit nën hetim deri në këtë fazë dyshohet të jetë ajo e shpërdorimit të detyrës, vepër penale e parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, si dhe për personin nën hetim nuk ekzistojnë kushte padënueshmërie si dhe ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit **“Pezullimin e ushtrimit të detyrës”** të parashikuar nga neni 240/1/b i K.Pr.Penale, Gjykata vlerëson se, kjo kërkesë e organit të akuzës është e bazuar në ligj.

Neni 242 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Me vendimin që disponon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, gjykata i ndalon përkohësisht të pandehurit, plotësisht ose pjesërisht, veprimtarinë që lidhet me to.”* Caktimi i masës ndaluese sipas kësaj dispozite zbatohet ndaj personit nën hetim/të pandehurit i cili është në një detyrë apo funksion publik gjatë kohës që ai është në një procedim penal. Kjo masë ndaluese në çdo rast caktohet kur plotësohen kushtet dhe kriteret që përcakton neni 228 i K. Pr. Penale. Një masë e tillë ndaluese nuk mund të caktohet ndaj personit nën hetim që nuk është duke ushtruar një detyrë apo funksion publik, sepse një masë e tillë nuk do të kishte kuptim dhe do të dilte jashtë qëllimit të ligjvënësit.

Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se marrja e një mase të tillë është e nevojshme pasi ekziston koneksiteti i kërkuar ndërmjet faktit penal dhe detyrës që ushtron personi nën hetim. Vepra penale për të cilën hetohet personi nën hetim dyshohet të jetë kryer për shkak të pozitës së veçantë që ka personi nën hetim, me detyrë President i FSHF-së, ku nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve ka mundësuar apo lejuar ardhjen e pasojave të paligjshme që vijnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Personi nën hetim rezulton të ketë qenë në dijeni të paligjshmërive të sipërcituara dhe nuk ka kryer asnjë veprim me qëllim parandalimin e situatës së paligjshme të krijuar (dyshuar për këtë fazë të hetimit). Pozita e tij dhe detyra kërkon që ai të marrë masa për parandalimin e situatave të paligjshme, dhe për këtë shkak një masë e tillë do t’i shërbente hetimit por edhe do të shërbejë si shkak për të parandaluar çdo dyshim për mundësinë për të ndërhyrë në vijueshmërinë normale të provave/hetimit.

Në caktimin e masës ndaluese parashikuar nga neni 242 i KPP, gjykata ka si qëllim ndërprerjen e aktivitetit të kundërligjshëm të tij në rrethanat konkrete të çështjes, pasi ushtrimi i detyrës së të dyshuarit ka lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij. Në këtë kontekst ka një rrezik real dhe nevojë për marrjen e një mase procedurale për të shmangur mundësinë që ka personi nën hetim, të vazhdojë aktivitetin e tij, e cila ka lidhje të drejtpërdrejte me veprimin e tij të kundërligjshëm.

Nga ana tjetër plotësohet edhe kushti formal i parashikuar nga neni 241 i KPP, lidhur me kushtet e zbatimit të masave ndaluese, i cili parashikon se, *masat ndaluese mund të zbatohen vetëm kur procedohet për vepra penale, për të cilat ligji cakton dënim me burgim më*

të lartë nëmaksimum se një vit. Vepra penale për të cilën dyshohet personi nën hetim parashikon dënim deri në shtatë vjet burgim.

Në lidhje me argumentin apo analizën e thelluar të provave, gjykata vlerëson se, për natyrën e këtij gjykimi, ndryshe kur ndaj të hetuarve caktohet një masë sigurimi shtrënguese, nga ato që kufizojnë lirinë e të hetuarit, e konkretisht masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të K. Pr. Penale (duke argumentuar shkaqet pse masat e tjera janë të papërshtatshme). Në rastin konkret, ndaj personit nën hetim është kërkuar të caktohet një masë ndaluese, për të cilat ligji procedural penal parashikon vetëm një kusht të posaçëm për zbatimin e tyre - ‘kur i hetuari procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit. Në rastin konkret, i hetuari dyshohet për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, i cili parashikon një dënim me burgim deri në shtatë vjet.

Në lidhje me llojin e masës ndaluese të kërkuar nga organi i akuzës, gjykata vlerëson se, nuk jemi në rastin e nenit 240/1/b dhe 243 të KPP, por në situatën e parashikuar nga neni 240/1/a dhe 242 të KPP. Neni 242 i KPP normon pezullimin e ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, ndërkohë që neni 243 normon ndalimin e ushtrimit të profesionit ose afariste në sektorin privat. të detyrave drejtuese në persona juridikë. Pyetja që shtrohet është: pozicioni i sekretarit të përgjithshëm të FSHF-së apo në detyrën e presidentit të FSHF-së konsiderohen një detyrë që futet në sferën e atyre shërbimeve që paraqesin interes publik (duke përjashtuar organet e administratës shtetërore pasi koncepti i shërbimit publik është më i gjërë se organet shtetërore) apo veprimtari afariste (private)?

Për të sqaruar këto pyetje, i referohemi ligjit Nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar, i cili në nenin në nenin 7/1 të tij normon: “*Sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik*”. Në vijim, neni 10 normon se: “*Organizimi kombëtar i sportit përbën tërësinë e organizatave e të institucioneve që ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit, të ndara në organizata sportive dhe struktura shtetërore për shërbime sportive*”. Ndërsa në nenin 11 parashikohet se: “*Organizatat sportive në Republikën e Shqipërisë janë: a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar; b) federatat sportive; c) shoqatat sportive; ç) shoqëritë sportive; d) klubet sportive*”. Në lidhje me financimin e tyre, në nenin 13 parashikohet se: “*1. Federatat sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Organizata Kombëtare Antidoping financohen me fonde të dhëna nga buxheti i shtetit në formë transfertë, të parashikuara në buxhetin e shtetit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme*”.

Së fundi, i referohemi edhe ligjit Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”. Neni 3 i tij normon se: “*Ky ligj zbatohet, si rregull, për të gjitha shërbimet që ofrohen nga institucionet e administratës shtetërore... nga institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në rastet dhe në mënyrën e përcaktuar në këtë ligj.*” Në vijim, neni 4, parg.10 i tij normon: “*Shërbim publik*” është produkti që u ofrohet nga institucionet e administratës shtetërore, të pavarura dhe të qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre, personave fizikë dhe juridikë, në bazë të kërkesës së tyre...”

Në kushte kur, sporti me ligj është parashikuar si një interes publik që tejkalon interesat private të mënyrës së organizimit të tyre në formën e OJF-së, konkludohet se edhe drejtuesit e tyre ushtrojnë një detyrë apo shërbim që i përket sferës publike.

Për sa më sipër, ndaj personit nën hetim duhet të caktohet masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale.

Çmohet nga gjykata që ushtrimi i detyres për personin nën hetim Armando Duka duhet të ndalohej plotësisht duke përjashtuar veprimet administrative për kryerje pagesash në favor të personit fizik ose juridik (paga, shlyerje kontratash e të tjera të kësaj natyre)

2.4 Caktimi i masës së sigurimit me karakter ndalues për personin nën hetim Koço Kokëdhima.

Në lidhje me personin nën hetim Koço Kokëdhima, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar si masë sigurimit “*Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste*”, të parashikuar nga neni 243 i K.Pr.Penale, pasi çmon se, në ngarkim të personit nën hetim, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ka konsumuar veprat penale “*Shpërdorimi i detyrës*” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Në rastin konkret, nga ana e organit të akuzës nuk është shpjeguar as koneksiteti ndërmjet pozitës së personit nën hetim dhe faktit penal apo mundësi të tij për të ndërhyrë në procesin e të provuarit duke vënë në rrezik vijueshmërinë normale të hetimit. Personi nën hetim është në pozitën e Kryetarit të Komisionit të Verifikimit pranë FSHF-së, organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së FSHF-së dhe kryerjen e kontrollit të integritetit.

Gjykata në rastin konkret konstaton se, caktimi i masës së sigurimit ndaj personit nën hetim nuk është i nevojshëm pasi nuk ekziston kushtet e parashikuar në pikën 3 shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 228/3 të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht nuk ka shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, personi nën hetim nuk është larguar dhe nuk ekziston rreziku i largimit, si dhe nuk provohet rreziku që për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të tij, mund të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Sa më sipër, gjykata nuk çmon të drejtë kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit ndaluese “*Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*” të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale, e në këto kushte vendosi të mos pranojë këtë kërkesë si të pabazuar në ligj e në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në mbështetje të neneve 228, 229, 240, 241, 242, 243, 244, 246/3 dhe 249/1 të Kodit të Procedurës Penale 186/3 dhe 248 të K.Penal,

VENDOSI:

1.Pranimin e kërkesës.

-Caktimin si masë sigurimi ndalues ndaj personit nën hetim **Ardian Haçi**,atë të *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”* të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

2.Pranimin e kërkesës

-Caktimin si masë sigurimi ndalues ndaj personit nën hetim **Illir Shulku**, atë të *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”* të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

3.Pranimin e kërkesës.

-Caktimin si masë sigurimi ndalues ndaj personit nën hetim **Armando Duka**, atë të *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”* të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

4.Rrëzimin e kërkesës për caktimin si masë sigurimi ndaluese ndaj personit nën hetim **Koço Kokëdhima**,atë të *“Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”* të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

5.Vendimi t’i njoftohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.Vendimi t’i njoftohet personave nën hetim **Ardian Afrim Haçi, Ilir Ismail Shulku, Armando Enver Duka dhe Koço Theodhori Kokëdhima**.

7.Kundër këtij vendimi për caktimin e masës së sigurimit lejohet ankim brënda 5 (pesë)ditëve duke filluar ky afat nga njoftimi i vendimit të Gjykatës.

U shpall në Tiranë sot më datë 27.02.2022.

GJYQTAR

Artan GJERMËNI

Shpenzime gjyqësore nuk ka!